

MEMORANDUMI I MIREKUPTIMIT

MIDIS

BANKES SE SHQIPERISE

DHE

AUTORITETIT BANKAR DHE TE PAGESAVE TE KOSOVES

MBI BASHKEPUNIMIN NE FUSHEN E MBIKEQYRJES BANKARE

PERMBAJTJA

Autoritetet kompetente	3
Përkufizimet	3
Sekreti Profesional	4
Shkëmbimi i informacionit	4
Licensimi, kontrolli i pronësisë dhe administrimi	4
Ekzaminimet On-site	5
Ligjet dhe rregulloret	6
Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe masat korrigjuese	6
Të ndryshme	7

Banka e Shqipërisë, (në vazhdim e njohur si: BSH), përfaqësuar nga Z. Ardian Fullani, Guvernator, dhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, (në vazhdim i njohur si: BPK), përfaqësuar nga Z. Michel Svetchine, Drejtor Ekzekutiv, që të dy të njohur në vazhdim si “Autoritete”, në mbështetje të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999, ku Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm të themelojë, me ndihmën e organizatave ndërkombëtare përkatëse, një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, të njohur si Misioni i Përkohshëm i Administrimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me qëllim që të sigurojë një administrim të përkohshëm në Kosovë sipas mandatit të përcaktuar në rezolutë,

dhe në njohje të karakterit të përkohshëm të BPK-së si pjesë e administrimit të përkohshëm në Kosovë,

shprehin gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar mbi bazën e besimit dhe mirëkuptimit reciprok dhe bien dakord për të mbështetur bashkëpunimin e tyre në fushën e mbikëqyrjes bankare mbi parimet dhe procedurat e përcaktuara në këtë memorandum.

Korniza e përgjithshme e këtij Memorandumi Mirëkuptimi janë parimet bazë për një mbikëqyrje bankare efektive sipas Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare në shtator të vitit 1997 (në vazhdim të njohura si: parimet bazë).

Bashkëpunimi i Autoriteteve në kuadër të këtij memorandumit do të realizohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit.

Qëllimi i këtij Memorandumi është të krijojë një bashkëpunim midis Autoriteteve me qëllim që të mundësojë efektivitetin e mbikëqyrjes dhe të sigurojë një mbikëqyrje të bankave mbi baza të konsoliduara.

Autoritetet kompetente

1. BSH është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen bankare sipas Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

BPK vepron si autoriteti mbikëqyrës bankar sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr. 1999/20, të amenduar mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe Rregullores së UNMIK-ut, nr. 1999/21 mbi Licensimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin Bankar.

Përkufizimet

2. Për qëllime të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, shprehjet në vazhdim do të kenë kuptimet përkatëse, si më poshtë:

Themelimi përtej kufijve:

“Një degë në një juridiksion që është themeluar nga një zyrë qendrore e një banke, e cila është licensuar në një juridiksion tjetër, ose një filial i licensuar në një juridiksion dhe që

	kontrollohet direkt ose indirekt nga një bankë mëmë, ku kjo e fundit është inkorporuar dhe licensuar në një juridiksion tjetër.”
Degë:	“Njësia organizative e licensuar në një juridiksion e një banke, e cila është inkorporuar dhe licensuar në një juridiksion tjetër.”
Filial:	“Një bankë e licensuar në një juridiksion, që kontrollohet direkt ose indirekt nga një bankë mëmë të inkorporuar dhe licensuar në një juridiksion tjetër.”
Mbikëqyrësi vendas:	“Autoriteti që mbikëqyr zyrën qendrore të bankës në rastin e degës, ose bankën mëmë në rastin e filialit.”
Mbikëqyrësi i huaj:	“Autoriteti që mbikëqyr një degë ose një filial brenda juridiksionit të tij.”

Sekreti profesional

3. Përputhja me detyrimet e sekretit profesional nga të gjithë punonjësit dhe zyrtarët që marrin informacion nga juridiksioni tjetër përkatës gjatë aktivitetit të tyre është një kusht i domosdoshëm për një bashkëpunim të suksesshëm midis autoriteteve. Autoritetet do të sigurojnë përputhshmëri të plotë me kriteret fillestare të parimeve bazë 1(6).

BSH është e detyruar të plotësojë kërkesat e sekretit profesional sipas përcaktimeve në Kapitullin 58 të Ligjit nr. 8269 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe në Kapitullin 23 të Ligjit nr. 8365 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

BPK është e detyruar të plotësojë kërkesat e sekretit profesional sipas përcaktimeve në Nenin 34 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/20, të amenduar.

Autoritetet nuk do t’u deklarojnë asnjë informacion konfidencial të tretëve pa miratimin me shkrim të autoritetit që ka siguruar këtë informacion konfidencial.

Në qoftë se deklarimi i një informacioni konfidencial për një autoritet vendas (si p.sh. Gjykatat, Administrata e tatim – taksave etj.) është kërkesë e ligjit shqiptar ose e ligjit që aplikohet në Kosovë, Autoritetet do të jenë të përpiktë për të njoftuar njëri-tjetrin në kohë.

Shkëmbimi i informacionit

4. Autoritetet miratojnë një parim të gjerë të shkëmbimit të informacionit midis njëri-tjetrit për të mbështetur dhe mundësuar detyrat e tyre mbikëqyrëse. Autoritetet theksojnë gatishmërinë për të ndarë informacion mbi ngjarjet që lidhen me Themelimet përtej kufijve si dhe me bankat e tyre mëmë që në planin rregullativ varen nga Mbikëqyrja Bankare e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës.

Në terma të gjëra kjo do të thotë se do të ketë kontakte, të shkruara ose gojore, sa herë që Mbikëqyrësi vendas ose i huaj e konsideron këtë të vlefshme ose të domosdoshme mbi bazën e fakteve apo zhvillimeve përkatëse për qëllime mbikëqyrëse të tijat apo të njëri-tjetrit. Në veçanti, Mbikëqyrësi i huaj do të lajmërojë në kohë Mbikëqyrësin vendas për çdo ngjarje që lidhet me degën apo filialin, e cila mund të rrezikojë stabilitetin e bankës në tërësi. Ata do të informojnë njëri-tjetrin mbi gjobat administrative të vendosura apo masave të tjera të marra ndaj degës, filialit apo bankës në tërësi, kur gjobat apo masat e tjera gjykohen të kenë një rëndësi thelbësore.

Gjithashtu, midis Autoriteteve do të ketë komunikime në lidhje me ndryshime të rëndësishme në rregulloret dhe politikat mbikëqyrëse vendase të secilës palë.

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit do të kryhet nga personat e autorizuar nga të dy Autoritetet.

Licensimi, kontrolli i pronësisë dhe administrimi

5. Në qoftë se një bankë e inkuorporuar në njërin prej dy juridiksioneve i drejtohet Autoritetit të juridiksionit tjetër për të themeluar një degë apo filial, ky i fundit duhet të informojë pa vonesë Mbikëqyrësin vendas. Në qoftë se kompetenca e Mbikëqyrësit vendas është një parakusht i parashikuar në statut, të cilin Mbikëqyrësi i huaj duhet ta marrë parasysh në procedurën e licensimit, ky i fundit mund të kontaktojë autoritetin e juridiksionit vendas për të zgjidhur çfarëdolloj çështjeje në këtë drejtim.

Mbikëqyrësi vendas informon Mbikëqyrësin e huaj mbi shumën e fondeve dhe mbi raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës mëmë, nëse banka mëmë është e autorizuar të ofrojë shërbime bankare dhe financiare, nëse ajo është totalisht e detyruar të respektojë kuadrin rregullator bankar vendas, dhe nëse pritet që në kuadrin e strukturës së saj organizative dhe të kontrollit të brendshëm të realizojë Themelimin përtej kufijve në një mënyrë të përshtatshme dhe të rregullt. Mbikëqyrësi vendas i deklaron çdo pjesë të informacionit të vlefshëm Mbikëqyrësit të huaj, që mund të shkaktojë dyshime mbi përshtatjen apo korrektësinë e drejtuesve të ardhshëm të Themelimit përtej kufijve.

Autoritetet do të konsultohen ose do të kërkojnë një miratim paraprak (nëse një miratim i tillë është parashikuar në rregulloren e Autoriteteve), përpara se t'i japin autorizimin një filiali të një banke të autorizuar në një juridiksion tjetër apo të vlerësojnë ndonjë pjesëmarrje aksionesh në një bankë vendase nëpërmjet një banke që operon në juridiksionin e një Autoriteti tjetër.

Mbikëqyrësi vendas do t'i sigurojë Mbikëqyrësit të huaj (me një kërkesë me shkrim dhe deri në një masë të arsyeshme) informacion mbi strukturën e aksionerëve, duke përfshirë dhe aksionerët me pjesëmarrje të rëndësishme aksionesh në bankën mëmë / bankën-qendër të një Themelimi përtej kufijve të inkuorporuar në juridiksionin e Mbikëqyrësit të huaj.

Mbikëqyrësi i huaj do t'i sigurojë mbikëqyrësit vendas (me një kërkesë me shkrim dhe deri në një masë të arsyeshme) informacion mbi strukturën e aksionerëve, duke përfshirë dhe aksionerët me pjesëmarrje të rëndësishme aksionesh në një filial të një banke mëmë të autorizuar në juridiksionin e Mbikëqyrësit vendas.

Veçanërisht, informacioni që i përket këtij paragrafi do të përfshijë ndryshime të rëndësishme në strukturën e aksionerëve të një banke përkatëse, që tregon se një njësi tjetër apo grup i njësive të lidhura ka marrë kontrollin e bankës.

Për qëllime të këtij paragrafi, me pjesëmarrës të rëndësishëm do të nënkuptohet një pjesëmarrje direkte ose indirekte prej 10 për qind ose më tepër të kapitalit ose të të drejtave votuese, dhe që bën të mundur të ushtrojë një ndikim të rëndësishëm mbi menaxhimin e bankës në të cilën ekziston pjesëmarrja.

Autoritetet e juridiksioneve përkatëse do t'i sigurojnë njëri-tjetrit informacion (me një kërkesë me shkrim dhe deri në një masë të arsyeshme) rreth individëve apo bizneseve të cilët kanë apo kërkojnë të marrin kontrollin e një ose disa bankave që janë të inkuorporuara në juridiksionin tjetër.

Ekzaminimet On-site

6. Duke njohur rëndësinë e mbikëqyrjes së konsoliduar, autoritetet bien dakord që bashkëpunimi i tyre të jetë veçanërisht i dobishëm duke ndihmuar njëri-tjetrin për realizimin e ekzaminimeve on-site të Themelimeve përtej kufijve.

Gjatë përgatitjes së planit të ekzaminimit, Mbikëqyrësi i huaj do të informojë Mbikëqyrësin vendas rreth periudhës së planifikuar për ekzaminimin on-site të filialit apo degës.

Mbikëqyrësi i huaj do të lejojë Mbikëqyrësin vendas të kryejë ekzaminimet e degës apo filialit në juridiksionin e huaj. Mbikëqyrësi i huaj do të lejojë ekzaminimet on-site, në bazë të një njoftimi paraprak të institucionit që do të ekzaminohet, mbi qëllimin e ekzaminimit, periudhën që mendohet të zgjasë ekzaminimi dhe personat që do ta kryejnë atë.

Mbikëqyrësi i huaj ka të drejtën të ketë përfaqësues që e shoqërojnë në çdo ekzaminim on-site. Sikurse është rënë dakord, Mbikëqyrësi i huaj do të informohet mbi rezultatet e ekzaminimeve të tilla on-site në një masë të arsyeshme dhe në kohën e duhur.

Ligjet dhe rregulloret

7. Autoritetet këshillojnë njëri-tjetrin sipas kërkesës mbi çdo aspekt të sistemit të tyre rregullativ dhe informojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm në ligjet dhe rregulloret e tyre, veçanërisht për ndryshime që kanë ndikim të rëndësishëm mbi aktivitetin e Themelimeve përtej kufijve, mbi zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me sektorin bankar, si dhe shkëmbejnë informacion rreth zhvillimeve të sektorit bankar në Shqipëri dhe Kosovë. Kjo nënkupton shkëmbim informacioni dhe – në rast nevojë – konsultime mbi skemën e garancisë të depozitave.

Informacioni do të shkëmbehet midis Autoriteteve në formë të shkruar ose gojore, me kërkesë ose jo, ashtu sikurse dhe gjatë sesioneve të konsultimit midis administratorëve të Autoriteteve dhe pjesës tjetër të stafit të zgjedhur.

Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe masat korrigjuese

8. Autoritetet informojnë njëri-tjetrin, në kohën e duhur dhe deri në një masë të arsyeshme, rreth çdo ngjarjeje që mund të rrezikojë stabilitetin e bankës që ka Themelime përtej kufijve në juridiksionin tjetër përkatës. Kjo në veçanti nënkupton:
 - krizat e para, çdo shkelje serioze të ligjit dhe rregulloreve të bankut të kujdesshëm, një rënie të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit nën nivelin minimal të lejuar nga Autoritetet mbi baza vetiako apo të konsoliduara, realizim të biznesit në atë mënyrë që dëmton interesin e depozituesve të bankës apo kërcënon sigurinë dhe stabilitetin e sistemit bankar, apo ëdo informacion tjetër të një natyre serioze;

Ata gjithashtu njoftojnë njëri-tjetrin rreth gjobave administrative që kanë vendosur apo çdo lloj mase tjetër që kanë marrë ndaj Themelimit përtej kufijve si Mbikëqyrës i huaj, nëse bazuar në gjykimin e tyre, informacioni i shërben Autoritetit, veçanërisht për:

- kufizimin dhe anulimin e disa aktiviteteve të deklaruara në licensë;
- kërkimin e ndryshimeve në Bordin e Drejtorëve (bordin ekzekutiv) të bankës;
- vendosjen e shumave të duhura të provigjoneve, rezervave dhe zërave të jashtëzakonshëm të fshirë nga bilanci;
- pakësimin e kapitalit fillestar të bankës;
- implementimin e administrimit të detyruar;
- revokimin e licensës;
- dhe çdo masë tjetër mbikëqyrëse të një rëndësie thelbësore.

Njoftimi midis autoriteteve do të bëhet me shkrim, në kohën e duhur dhe pa vonesa të tepruara. Autoritetet diskutojnë me njëri-tjetrin mbi çdo informacion të rëndësishëm rreth bankave që kanë Themelime përtej kufijve në Kosovë dhe Shqipëri. Përfaqësuesit e Autoriteteve organizojnë takime *ad-hoc* për të nxitur zgjidhjen e problemeve mbikëqyrëse që lidhen me Themelimet përtej kufijve në Shqipëri dhe Kosovë, sa herë që njëra palë e gjykon të nevojshme.

Të ndryshme

Asgjë që përfshihet apo ka lidhje me këtë Memorandum nuk do të gjykohet si heqje dorë, në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, e ndonjë prej privilegjeve apo imuniteteve të Kombeve të Bashkuara, përfshirë dhe UNMIK-un.

Autoritetet do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur në rrugë miqësore çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga ky Memorandum.

Ky Memorandum hyn në fuqi dhe zbatimi i tij bëhet i detyrueshëm pas nënshkrimit nga të dy palët.

Autoritetet do të vazhdojnë të respektojnë afatet e këtij Memorandumi, derisa njëra prej palëve të kërkojë përfundimin e tij. Ky Memorandum do të jetë i vlefshëm deri në 30 ditë pasi njëri prej Autoriteteve të ketë njoftuar me shkrim palën tjetër, ku i tregon qëllimin e tij për ta përfunduar këtë Memorandum. Gjithsesi, Autoritetet do të respektojnë kërkesën e fundit dhe ekzistuese për ndihmë, të paraqitur përpara një njoftimi të tillë (mbi përfundimin e Memorandumit), nëse kjo është e mundur sipas kushteve të përcaktuara në këtë Memorandum.

Të dy palët kontraktuese bien dakord që ky Memorandum të ndryshohet apo amendohet vetëm me miratim me shkrim nga të dy palët.

Pas nënshkrimit të këtij Memorandumi, brenda 10 ditëve, Autoritetet do të shkëmbejnë listat e personelit të autorizuar, bashkë me detajet e plota mbi kontaktimin e tyre. Kjo listë e personave të autorizuar do të përditësohet rregullisht ose në rastet kur lista mund të ketë ndryshime.

Autoritetet bien dakord të realizojnë takime në mënyrë të rregullt, me qëllim që të diskutojnë mbi çështje të ndryshme që lidhen me mbikëqyrjen e kujdesshme të bankave të themeluara në të dy juridiksionet si dhe mbi zhvillimet e sistemeve të tyre rregullative dhe mbikëqyrëse mbi baza vjetore.

Përpiluar, për shkëmbim dokumenti, në dy kopje në gjuhën angleze, ku të dyja kopjet janë autentike.

NENSHKRUAR në _____, me datë _____

Për dhe në emër të Bankës së Shqipërisë

Ardian Fullani

Governator

Për dhe në emër të Autoritetit Bankar e të
Pagesave të Kosovës

Michel Svetchine

Drejtor Ekzekutiv